



*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*



Instituti për Planifikim Hapësinor
Institut za Prostorno Planiranje
Institute of Spatial Planning

F T E S Ë

I nderuar Zotëri / Zonjë,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misionin në Kosovë dhe me përkrahjen e UN-Habitat Kosova/SwEPA, ka kënaqësinë t'ju ftojë në:

SHQYRTIM PUBLIK

Draft - Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Sharri"
Draft - Raporti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për PH të Parkut Kombëtar "Sharri"

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke qenë institucioni përgjegjës për hartimin dhe bashkërendimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor ka hartuar draftin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri si dhe draftin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri".

Parku Kombëtar "Sharri" është një nga pasuritë më të rëndësishme natyrore në rajonin tonë, i njohur për biodiversitetin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Ky plan synon të balancojë zhvillimin e qëndrueshëm me ruajtjen e këtij ekosistemi unik.

Pjesëmarrja dhe diskutimi me të gjitha palët e interesuara përfshirë edhe publikun e gjerë, përtej obligimeve ligjore të ministrisë ka për qëllim që t'ju mundësojë të gjitha palëve që të prezantojnë shqetësimet dhe interesat e tyre lidhur me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri" dhe të marrin përgjigje profesionale nga zyrtarët e ministrisë.

Debatet nëpër komuna do të mbahen sipas orarit të mëposhtëm:

- **Debati në Prizren** 08.04.2025 prej orës 10-12 në Hotel Premium Park, Prizren
- **Debati në Suharekë** 15.04.2025 prej orës 10-12; te konfirmohet
- **Debati në Dragash** 16.04.2025 prej orës 10-12; te konfirmohet
- **Debati në Shtërpce** 17.04.2025 prej orës 10-12; te konfirmohet
- **Debati në Kaçanik** 22.04.2025 prej orës 10-12; te konfirmohet

Mirëpresim pjesëmarrjen tuaj.

AGJENDA - PRIZREN

Ngjarja: **Shqyrtim Publik për Draftin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri", dhe Draftin e Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për PH të Parkut Kombëtar "Sharri"**

Vendi: Hotel Premium Park, Prizren

Data: 8 Prill 2025

09:30 - 10:00 Mirëseardhje & Kafe

10.00 - 10.10 Fjalimet hyrëse

10.20 - 10.40 Prezantim: draft-Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Sharri"

10.40 - 11.00 Prezantim: draft - Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për draft-Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri"

11.00 - 11.30 Debat i hapur

11.30 - 12.00 Hapat e ardhshëm dhe mbyllja e debatit publik

12:00 - 13:00 Dreka